V E N D I M
Nr.280, datë 9.5.1998

SHPALLJEN SI OBJEKT I RËNDËSISË SË VEÇANTË SHTETËRORE TË AEROPORTIT TË RINASIT

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe në mbështetje të nenit 3 shkronja "a" të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992 "Për policinë e objekteve", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen si objekt të rëndësishëm shtetëror të Aeroportit të Rinasit dhe marrjen në ruajtje nga policia e objekteve të Ministrisë së Rendit Publik.

2. Ministrisë së Rendit Publik, për ruajtjen e këtij objekti, i shtohen në organikë 52 punonjës policie.

3. Shpenzimet në shumën prej 25 milionë lekësh për ruajtjen e këtij objekti të përballohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, nga të ardhurat që realizohen nga taksat e ulje-ngritjes dhe të mbikalimeve ajrore të avionëve në përputhje me nenin 3 paragrafi i fundit i ligjit nr.8248, datë 6.10.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë"".

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Rendit Publik që, me përfundimin e rrethimit të territorit të Aeroportit të Rinasit, të reduktojnë numrin e punonjësve të policisë për ruajtjen e këtij objekti dhe shpenzimet e ruajtjes të përballohen nga ndërmarrja e Albtransportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano